



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.02.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Prezantimi i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10416, datë 07.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", i ndryshuar" (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Arben Pëllumbi, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Vullnet Sinaj dhe Edmond Panariti.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Dhimitër Kote – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Edlira Llango – Drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Vlash Tirana – Drejtor i Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Meqë plotësohet kuorumi, fillojmë mbledhjen e komisionit.

Sot në rendin e ditës kemi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10416, datë 07.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", i ndryshuar”. Ky është një projektligj, i cili ka qëllim kryesisht deregulimin dhe disa përmirësime në sistemin e laboratorëve.

Relator është deputeti Ilir Ndraxhi, i cili do të bëjë një prezantim të shkurtër.

Pastaj përfaqësuesit e ministrisë, zëvendësministri Dhimo dhe drejtoresha Llango janë këtu për pyetje dhe për komente.

Zoti Ndraxhi.

Ilir Ndraxhi – Faleminderit, kryetar!

Relacion për projektligjin Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10416, datë 07.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", i ndryshuar”

Ky projektligj vjen në kuadër të reformës së deregulimit për përmirësimin e klimës së biznesit nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative. Me anë të këtij projektligji propozohet shfuqizimi i licencës “Prodhimi dhe/ose tregtimi i farave dhe fidanëve”, me kodin II, pika 4. Me shfuqizimin e kësaj licence, ushtrimi i veprimtarisë së prodhimit dhe/ose tregtimit të farave dhe fidanëve do të jetë i lirë, por kjo nuk do të pengojë punën e inspektorëve të AKU-së për të kontrolluar përmbushjen e kushteve që duhet të plotësojnë subjektet për përshtatshmërinë e ambienteve dhe mjediseve për përpunimin, paketimin, ruajtjen dhe tregtimin e farave për të siguruar temperaturën dhe lagështirën optimale për ruajtjen e treguesve cilësorë dhe parametrave teknikë për farat. Gjithashtu, projektligji parashikon se prodhimi i kategorive të larta të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor bëhet nga furnizues publikë të autorizuar ose privatë të regjistruar në regjistrin tregtar të QKB-së. Përveç heqjes së kësaj licence, projektligji synon të bëjë disa përmirësime të nevojshme në fushën e analizimit të materialit mbjellës e shumëzues bimor në laboratorët e miratuar dhe atë të referencës për të vendosur në treg material mbjellës e shumëzues bimor me cilësinë e kërkuar.

Projektligji përcakton se laborator i referencës miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë, si dhe shërben si laborator i vlerësimit të cilësisë dhe besueshmërisë së

analizave të kryera në laboratorë të tjerë. Kjo lidhet me kërkesat e biznesit dhe të Entit Shtetëror të Farave e AKU-së për të ndryshuar përcaktimet e ligjit, sipas të cilit analizat laboratorike zyrtare të materialit mbjellës e shumëzues bimor, kryhen në laboratorë të akredituar dhe të miratuar për këtë qëllim, gjë që bie në kundërshtim me praktikën e deritanishme të kryerjes së analizave në laboratorët qendrorë të Entit Shtetëror të Farave e Fidanëve, ose laboratorët e tjerë të strukturave në varësi të Ministrisë së Bujqësisë. Ky ndryshim i siguron bizneset, që importojnë materiale mbjellëse dhe shumëzuese bimore nga vendet e BE-së apo nga vende që kanë nënshkruar marrëveshjet me UPOV-in, kryerjen e analizave të besueshme dhe me cilësi, si dhe i siguron fermerët se materiali mbjellës e shumëzues bimor, që vendoset në treg dhe që përdoret nga ata për mbjelljen e bimëve bujqësore është i cilësisë së kërkuar dhe se analizat e kryera janë të besueshme.

Ky ndryshim do të ndikojë në kryerjen e analizave laboratorike zyrtare të materialeve mbjellëse e shumëzuese bimore në laboratorë të miratuar dhe në atë të referencës në përputhje me standardet bashkëkohore; në miratimin e laboratorit të referencës, si laborator që vlerëson cilësinë dhe besueshmërinë e analizave të materialit mbjellës e shumëzues bimor nga laboratorët e miratuar; në përcaktimin e procedurave që ndiqen për marrjen e mostrave, lëvizjen e tyre, kryerjen e analizave dhe njoftimin e subjekteve për rezultatet e tyre; në akreditimin e laboratorit të referencës brenda dy vjetve nga një institucion i pavarur.

Ky projektligj është konsultuar me grupet e interesit dhe me institucionet zbatuese, si Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, AKU-ja, qendrat e transformimit të teknologjive bujqësore, si dhe subjektet “Agroblend”, “Arli internacionale”, Agrohelf” dhe “Agroinput-Jazxhi”.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Ndraxhi!

A ka ndonjë sqarim shtesë nga ministria?

Dhimitër Kote – Jo, nuk kemi gjë. Nëse ka pyetje apo kërkohet ndonjë sqarim, jemi të gatshëm të përgjigjemi.

Niko Peleshi – A ka ndonjë pyetje?

Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Së pari, zoti Zëvendësministër, mirë se keni ardhur në komision! Kjo vonesa, me sa duket, qenka e kuptueshme pse paska ndodhur deri më sot...

Dua të bëj një pyetje për të kuptuar më shumë: a ka sot laboratorë reference dhe sa të tillë janë? A ka sot laboratorë të akredituar dhe sa janë? A ka sot laboratorë të miratuar dhe sa janë? Çfarë statusi kanë? Janë publikë apo privatë?

Në bazë të këtyre përgjigjeve, kam një sekuençë shumë të gjatë pyetjesh, por duhet të kuptoj njëherë këtë gjë.

Niko Peleshi – Po, zoti Bitri.

Pastaj e ka fjalën zoti Baraj.

Robert Bitri – Në përgjithësi, cila është metoda që ndjekim me farat? Sa firma kemi ne që sjellin fara dhe fidanë në Republikën e Shqipërisë? Cili është qëndrimi që mbajmë ndaj atyre që i futin në mënyrë informale farat në Republikën e Shqipërisë?

Niko Peleshi – Zoti Baraj.

Pastaj zoti Sinaj.

Besnik Baraj – Faleminderit!

Unë nuk jam specialist i kësaj fushë, por, duke i hedhur një sy të shpejtë projektligjit, dua të bëj një koment në formën e një sugjerimi. Universiteti Bujqësor ka qenë qendra më e madhe shkencore, me besueshmërinë më të lartë në vend për dekada me radhë. Pavarësisht se çfarë ka ndodhur nëpër universitete në Shqipëri, unë mendoj se kjo qendër është ende qendra më e madhe shkencore me besueshmërinë më të lartë. Në mënyrë analoge të ky ligj ose edhe në ligje të tjera që na vijnë këtu, vë re me keqardhje se universitetet nuk janë të përfshira për të luajtur një rol edhe në këtë drejtim, për të qenë sisteme referimi. Për fat të keq, vë re se një mori laboratorësh në sektorë të ndryshëm janë fiktivë, janë pa parametra, pavarësisht se certifikohen me standarde të tjera, nuk kanë atë seriozitet, atë ndershmëri dhe atë besueshmëri që ofrojnë për mua kapacitetet universitare, të cilat edhe nëpërmjet ligjeve duhet t'i involvojmë.

Niko Peleshi – Po, zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Faleminderit, kryetar!

Ndryshimet e këtij projektligji lidhen me dy pika kryesore:

E para, është liberalizimi i tregut për importet e farave; e dyta, kontrollet nga laboratorë të akredituar dhe të certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

Pyetjet e parë: ky liberalizim i importeve a mund të përballohet nga AKU-ja dhe nga këta laboratorë për të bërë analiza? A ka ndonjë risk që, duke u liberalizuar, do të na vështirësojë

mundësinë e kontrollit të këtyre farave që importohen, pasi kemi vërejtje nga fermerët tanë, sepse shpeshherë kanë dështuar me këto fara?

Pyetja e dytë: kush do të përgjigjet apo çfarë parashikon ky ligj për farat, në rast se fermerët dështojnë në mbjelljen e tokave të tyre me këto fara, pasi kam raste të marra nga zona, sidomos me farën e jonxhës që është edhe një farë e kushtueshme, që kanë dështuar? Problem është jo vetëm fara që mbillet, por edhe sipërfaqja ku mbillet. Kush do të përgjigjet dhe si do të përgjigjen këta importues apo laboratorë të këtyre fermerëve për dëmet që u shkaktohen?

Faleminderit!

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera?

Po, zoti Panariti.

Edmond Panariti – Në radhë të parë, dëshiroj të falënderoj zëvendësministrin dhe përfaqësuesit e ministrisë, të cilët kanë ardhur për të paraqitur këtë projektligj, të cilin unë e konsideroj shumë të rëndësishëm!

Së pari, fara është gjeneza e bujqësisë. Në qoftë se ne dështojmë me farën, ka marrë fund çdo gjë. Fara dhe fidani është fillesa, pastaj të gjitha të tjerat janë në funksion të tyre. Nëse bëjmë një hap fals në drejtim të farës e të fidanit, atëherë e kemi hedhur në erë që në fillim të gjithë prodhimin bujqësor. Për këtë arsye në parim unë jam kundër liberalizimit të tregut të importit të farave. Të importosh fara fidanësh nuk është si të importosh çorape dhe këpucë.

Pra, mjafton t'ju kujtoj diçka. Provoni të futeni në SHBA si qytetar i thjeshtë pa plotësuar një formular, ku do të deklaroni me përgjegjësi që ju nuk mbartni fara, material bimor dhe kundërsankione. Pra, normalisht në rast si i nënshtroheni një kontrolli në hyrje të doganës dhe keni një farë, një fidan, ju përballeni me sanksione jashtëzakonisht të forta. Ata janë jashtëzakonisht striktë në drejtim të futjes së materialeve bimore. Këtu del pyetja: çfarë mekanizimi infiltrohet kemi ne në dogana, sepse një pjesë e farave e fidanëve vijnë me çanta? Ajo është e vogël dhe futet në xhep e mund të kalojë. A kemi ne ndonjë normim, ose të paktën një sanksion që të bëhet e qartë, qoftë edhe në një formular që duhet ta plotësohet në hyrje të doganës, apo ndonjë pyetje të drejtpërdrejtë që doganieri do t'i bëjë atij që hyn me makinë, me avion apo me traget? “A ke me vete material bimor, fara, fidanë?” Pra, ai duhet ta deklarojë këtë. Natyrisht, pastaj nëpërmjet sondazheve duhet t'i evidentosh që të mos futet një material i tillë bimor, pastaj nuk ka vlerë që të bësh një laborator, të ndërtosh kapacitete, ndërkohë që ai fut...

Pavarësisht nga certifikimi që mund t'i bëhet apriori, ose nëpërmjet analizave nga laboratorë të akredituar, ju kujtohet që Enveri, të cilit nuk dua t'i referohem, kishte dy vjet parcela eksperimentale. Nuk hidhej absolutisht as edhe një material bimor në prodhim të gjerë pa iu nënshtruar një testi dyvjeçar. Pra, edhe kur bëheshin farat hibride nga instituti i misrit dhe i orizit, kalonte një periudhë eksperimentale për të parë fuqinë mbirëse. U shtrua një pyetje se kush e mban përgjegjësi që do të hidhet në erë prodhimi. Ajo që është më kryesorja, sepse ne po flasim vetëm për parametrat normalë të një fidani apo të një fare, është fuqia mbirëse, është hibrid apo jo, është varietetet me linjë të pastër; është OMGJ apo nuk është. Po kush mban përgjegjësi, sepse farat dhe fidanët janë mbartëse të infeksioneve shumë të rrezikshme? Mund të të vijë një virus, i cili mund të të hedhë në erë të gjithë prodhimin. Mund të të vijë një bakter, një parazit me atë farë, të cilën ti e hedh, por e përhap infeksionin me dorën tënde. Pra, problemi është shumë kompleks. Këtu kemi dy gjëra: është enti i farave. Unë kam qenë vetë ministër, apriori i kam pranuar procedurat e tyre të analizës, të kontrollit, të fuqisë mbirëse, por kush e bën kontrollin e parazitëve, të infeksioneve e të viruseve? A e bën Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë? AKU-ja e bën normalisht. A duhet të akreditojmë edhe ne një laborator, krahas vlerësimit të fuqisë mbirëse të llojit të farës, nëse është hibrid, varietet i pastër, është OMGJ, dhe kjo kërkon kapacitete laboratorike?

E treta, laborator reference është një fjalë jashtëzakonisht e madhe. Laboratorë reference në nivel të Europës për këtë punë janë dy ose tre. Është tjetër gjë laborator i akredituar. Laboratori i referencës është entitet juridik. Pra, në momentin kur ti ke përplasje që laboratori i akredituar ta nxjerrë, kurse prodhuesi nuk e njeh dhe thotë jo, atëherë i drejtohesh një qendre të tretë, e cila jo domosdoshmërisht është brenda vendit. Është një qendër ndërkombëtare. Po ju them, besoj se specialistët e dinë, që në Europë nuk janë më tepër se 2-3 qendra, të cilat janë qendra me statusin e zgjidhjes së konflikteve. Pra, normalisht, kur ke përplasje midis të dhënave të laboratorit të akredituar kombëtar, ne duhet të kemi një laborator të akredituar kombëtar, por qendra e referencës kombëtare... Ju lutem, shikojeni se një qendër reference kombëtare duhet të jetë në gjendje, në radhë të parë, të marrë pjesë në ato që quhen analizat “unazë”. Pavarësisht se mund ta rregullojë me ligj, se është mirë ta kemi të normuar me ligj, unë dëshiroj që të jemi në gjendje të krijojmë një qendër reference kombëtare. Jo se nuk kam besim te kërkimi dhe te shkenca shqiptare, por mendoj se edhe në Europë, te vendet më të zhvilluara nuk ka më tepër se dy-tri qendra. Pra, ne normalisht duhet të përcaktojmë se kujt do t'i referohemi, do t'i referohemi

italianit, në qoftë se ai e ka, apo gjermanit dhe a keni hapur një qendër të miratuar nga Bashkimi European për zgjidhjen e konflikteve që ne mund të kemi dhe do të kemi në të ardhmen? A ju kujtohet se çfarë ndodhi në vitet 2006-2007, kur u fut misri i famshëm OMGJ, i cili në gjeneratën e parë prodhohej, por kur fshatarët e rimbollën farën doli komplet kall? Askush nuk e informoi fermerin që ai përdorej vetëm një herë dhe nuk mund të përdoret për farë të dytë. Kjo e çoi në një katastrofë të madhe dhe fermerët dolën jashtë loje. Distributori, natyrisht, ishte në të drejtën e tij, sepse ajo është një farë që vjen për një përdorim, sepse përndryshe ai që e shet falimenton, por duhet transparencë dhe t'i bëhet e ditur fermerit që kjo farë që po merr është për gjeneratën e parë, por nuk mund ta marrësh dhe ta përdorësh herën e dytë dhe të tretë, sepse nuk funksionon. Kjo punë duhej rregulluar edhe nga laboratorit i akredituar dhe të ishte vërtetuar se ajo farë ishte OMGJ, farë e modifikuar gjenetikisht, e cila ishte njëpërdorimshme. Kjo është si antivirusi, që ta jep 60 ditë falas dhe po e kalove afatin duhet të paguash, sepse nuk të mbron më. Të gjitha këto duhen parashikuar dhe një pjesë e tyre duhet të rregullohen edhe me akte normative nënligjore.

Shqetësim imi i madh është se çfarë do të bëjmë në dogana, pasi aty kalon gjysma e materialit biologjik fidanor dhe farishte, pa qenë nevoja për një firmë të certifikuar që e shet, të cilën e kalojnë me çantë. Si do të bëjmë dhe çfarë sanksioni do të krijojmë në nivel dogane?! Kjo është një kontrabandë, por me pasoja shumë të mëdha, sepse nga aty mund të sillen infeksione, mund të sillen sëmundje virale dhe mund të shkatërrosh genofondin shqiptar, sepse fut një farë agresive, e cila konkurron...

Besoj se ju kujtohet në vitet 2004-2005 kur erdhi ndihmë nga SHBA-të fara e deklaruar OMGJ, u bë zhurmë e madhe dhe dolën grupet tona ambientaliste dhe thanë: “Jo ashtu, jo kështu”, por ajo ishte e deklaruar dhe ishte material për t’u ngrënë, jo për t’u mbjellë. Çfarë ndodhë me materialin që hyn kontrabandë? Shteti, të paktën, duhet të tregoj dhëmbët, sepse unë e di që doganieri nuk ka ndonjë aparat ta vërtetojë, por në momentin që ti fut farë apo fidanë dhe të kapin në bagazhe apo në çantë, për mua duhet konsideruar si një vepër shumë e rëndë dhe me sanksione penale. Referojuni asaj që ndodhë në doganat e SHBA-ve, ku unë di raste që kanë përfunduar në burg, sepse kanë futur material bimor pa kontroll. Në një kontroll spontan që bënë ata gjetën material bimor kontrabandë dhe përfunduan në burg. Ata ruajnë, si sytë e ballit, genofondin e tyre. Ti duhet t’ia bësh të qartë qytetarit, pastaj le ta marrë vetë përsipër riskun. Kjo duhet bërë me një shpallje në doganë: “Çdo njeri që fut material bimor, farë apo fidanë përballet

me sanksione”, përndryshe, e gjitha kjo është një piramidë e kotë. Nuk e di nëse në këtë ligj mund të parashikohet diçka e tillë, ose të mund ta fusim në Kodin Penal, por duhet parë se ku duhet ta bëjmë këtë hap, që të pengojmë futjen e tyre dhe të mos kemi drama të mëdha si: dështime në mbjellje dhe infeksione që mund të futen.

Niko Peleshi – Fjalën e ka zoti Beqaj, pastaj zoti Baraj.

Ilir Beqaj – Kryetar, ne kemi një ligj, i cili ka një objekt dhe, këtu po flasim për të rregulluar një veprimtari të ligjshme. Në Shqipëri mund të hyjnë, dhe është zbuluar që hyjnë, edhe barna, edhe armë kontrabandë, edhe materiale bërthamore kontrabandë, të cilat janë të rregulluara në Kodin Penal, sepse paligjshmëria në Shqipëri rregullohet në Kodin Penal. Ka më shumë se një vit e gjysmë që opozita bllokoi çdo ndryshim të Kodit Penal, duke filluar që nga dhuna në familje dhe shumë çështje të tjera. Në qoftë se opozita e ka këtë vullnet, për të bërë një debat më të gjerë për të gjitha paligjshmëritë në Shqipëri, bujrum, le ta bëjë, dhe ia kërkojmë në mënyrë të përsëritur këtë. Kujtohuni se çfarë drame i shkaktoi opozita në verë të gjithë emigrantëve, kur deputeti Pjerin Ndreu propozoi një ndryshim të thjeshtë në Kodin Rrugor dhe opozita vetëm për politikë mbajti peng të gjithë emigrantët shqiptarë. Kështu që, në qoftë se do të përqendrohemi te pjesa e ligjshmërisë, ne ligjet i bëjmë për procedurë të ligjshme dhe kush ka vendosur të shkelë ligjin, i del për zot të gjitha gjërave. Në Amerikë na bllokojnë si qytetarë dhe jo si tregtarë të autorizuar materiali shumues.

Ju lutem, të vazhdojmë me pyetjet!

Faleminderit!

Edmond Panariti – Askush nga ne nuk ka interes të kalojë një ligj pa garantuar mekanizmat që ky ligj do të zbatohet, sepse ti mund të bësh sa të duash ligje, por në qoftë se ai të fut material kontrabandë, atëherë ky ligj është i mirë në letër, por nuk ka asnjë shans që të zbatohet. A ka vend që barrierat të mbrojtjes së futjes së paligjshme të materialit bimor të pasqyrohen dhe të rregullohen nëpërmjet ligjit?

Niko Peleshi – Zoti Baraj, fjala për ju.

Besnik Baraj- Është e vërtetë ajo që thatë ju, se ka pak qendra reference në Europë, por kurrësi nuk e shoh të panevojshme ngritjen e sistemeve të referencës në Shqipëri. Ne kemi eksportuar minerale, bimë dhe produkte të ndryshme në dekada dhe qendrat e referencës luajnë rolin e arbitrazhit kur hidhen. Ne nuk kemi statusin financiar që çdo gjë që vjen këtu t’ua çojmë

qendrave të referencës, por duhet të ketë një qendër të mirëfilltë, më të besueshme dhe më profesionale që është investuar më shumë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bitri, këto janë kapacitete që i ka çdo shtet, sado i vogël të jetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bitri, ne duhet ta kishim përcaktuar që në fillim se çfarë quajmë qendër reference dhe ne...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Qendrën e referencës ne e lidhim kryesisht me arbitrazhin në marrëdhënie me shtetet e tjera, por ne kemi nevojë për një qendër reference brenda vendit tënd për problematikat e brendshme. Jo të gjitha problematikat që kemi do t'i çojmë atje dhe të derdhim para për të bërë vlerësimin. Këto janë për raste të veçanta. Qendër reference apo qendër të akredituar unë do të përkufizoj qendrën më të besueshme, që në Shqipëri duhet të ketë një të tillë, në mënyrë që të referohen problematikat e brendshme, pastaj për në arbitrazh ato janë të përcaktuara dhe shkon e zgjidh atje për analizë kimike, biokimike, analizë farash e të tjerë. Prandaj, unë them që ne, krahas ligjeve, duhet të rritim, minimalisht siç ka qenë përpara, por edhe më tej, kapacitetet analitike në sektorë të ndryshëm dhe në këtë sektorë që janë të rëndësishëm për njeriun, për ushqimin dhe për shumë aspekte.

Niko Peleshi –A ka pyetje të tjera?

Edmond Panariti –Akreditimin do ta quajmë akreditim kombëtar apo ndërkombëtar?

Ka një qendër kombëtare akreditimi, që mund ta bëjë...

Vullnet Sinaj – Neni 1, e përcakton qartësisht se laborator reference është laborator i akredituar që vlerëson cilësinë dhe besueshmërinë e analizave të kryera nga laboratorë të akredituar dhe jep vlerësimin përfundimtar të testeve të kryera.

Edmond Panariti - Ne kemi një qendër kombëtare të akreditimit, ku normalisht çdo laborator mund të akreditohet atje.

Niko Peleshi - Zoti Panariti, të dëgjojmë përgjigjet e përfaqësuesve të ministrisë dhe më pas të komentojmë.

Dhimitër Kote – Unë kam ardhur bashkë me ekipin, që është marrë me këtë punë dhe ju falënderoj për pyetjet, diskutimet dhe ndërhyrjet që u bënë, të cilat i dëgjova me shumë

vëmendje. Populli thotë: “Çfarë do të mbjellësh do të korrësh” dhe e gjithë beteja fillon te mbjellja.

Historia ka qenë edhe e dhimbshme edhe e suksesshme dhe kjo ka bërë që gjërat evoluojnë dhe, siç e tha Zoti Panariti, bujqësia është rritur, eksporti është rritur, produktet në treg janë rritur dhe kjo tregon që bujqësia shqiptare është drejt farërave me kapacitete prodhuese dhe me inpute bujqësore cilësore. Nuk mund të konkurrojmë në treg me fara dhe kapacitet prodhues të vogël të misrit me 60-70 kuintal, siç ishte “Rozafa” dikur, kur ka misra me kapacitete deri në 150-200 kuintal, kur ka fara domatesh që prodhohen dyfish sot, agrumet prodhonin 40 kilogramë, ndërsa sot prodhohen 150 kilogramë. Pra, dua të them që është një punë që vetë konkurrenca dhe tregu e bëjnë këtë seleksionim. Ata mund të bien viktimë një herë ose dy herë, por jo më shumë. Domethënë, siguria e kësaj gjëje është pjesë e sigurisë kombëtare. Pra, duke pasur fidanë të garantuar...

Unë jam dakord me të gjitha mendimet që u dhanë këtu, sepse ajo është një zonë e mbrojtur dhe nuk lejojnë që një material tonin ta çojnë nga Greqia në Shqipëri, qoftë edhe pemë dekorative do ta kapin, sepse ka sëmundje virusale, që kanë krijuar shumë shqetësime, ku kemi pasur edhe situata dështuese.

Unë po filloj me pyetjet duke iu përgjigjur dhe komentuar ato pa marrë shumë kohë.

Nga eksperiencia që unë kam në profesion si agronom, edhe si zëvendësministër, por edhe si njeri që është marrë me biznesin e fidanit kuptohet që ka pasur edhe dështime në sjelljen e fidanëve, sepse duke e ditur edhe kërkesën që Shqipëria është një vend në zhvillim, ka kërkuar fidanë në disa vende të rajonit, të cilat e kanë shfrytëzuar këtë rast duke dhënë fidanë që prodhohet shpejt, por që plaket shpejt. Kjo është një e keqe e madhe, ku bota ka hyrë thellësisht në këtë gjë dhe ka arritur në konkluzionin që duhet të prodhohet ngadalë dhe të plaket ngadalë. Drurët frutor dhe agrumet duhet të jetojnë 60 vjet, por pemët dhe fidanët që marrim ne nuk e kanë këtë rezistencë. Prandaj dua të them se kjo është kthyer në biznes dhe kur kthehet i tillë është një dëm që i bëhet bujqësisë.

Ne, nga eksperiencia e të gjithë njerëzve që kanë kaluar në bujqësi, që kanë drejtuar ministrinë e bujqësisë dhe kanë drejtuar institucionet, kemi parë që janë disa problematika, të cilat nga partizanllëku, tifozllëku apo politika kanë dëmtuar institucione shumë të rëndësishme. Ju mund të thoni çfarë të doni, por institucionet që kanë qenë me shumë eficiencë, shumë seriozë dhe me besim ndërkombëtar janë prishur. Ne vuajmë për besim dhe, që të kesh besim duhet të

kesh institucione bindëse të akredituara. Ne kishim Institutin e Mbrojtjes së Bimëve, që ka qenë i përkryer dhe në nivel shumë të lartë, i cili duhet rimëkëmbur, në mënyrë që të bëjë evidentimin e dëmtuesve dhe të të parazitëve. Parlamenti, për ringritjen e atij instituti, ia ka kaluar kompetencat Ministrisë së Bujqësisë, që të orientojë drejtë dhe të bëjë analizat e të gjitha fidanëve dhe materialeve shumues. Ne duhet të merremi me këtë punë, sepse në qoftë se merresh me bujqësinë, duhet të merresh edhe me laboratorët.

Pyetjes së zotit Beqaj nëse ka laboratorë të akredituar, i përgjigjem se ka laboratorë të akredituar në Entin e Farave dhe në Institutin e Mbrojtjes së Bimëve, që është në universitet.

Për sa i përket problemit se cila është metoda që ndjekin me fara. Janë rreth 72 kompani që importojnë, por edhe që prodhojnë në vendin tonë fara, janë të licencuara për disa vjet. Material mbjellës quhet materiali kur merr një fidan të gatshëm, të cilin e mbjellë, dhe material shumëzues quhet kur merr një fidan dhe prodhon farë, që shumëzon farën. Kështu që, ne mendojmë se në Shqipëri punohet me fara të gjeneracionit të parë elitë.

Pyetjes nëse ka dështim, sigurisht që dështime ka në të gjithë botën. Fuqia mbirëse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, nëse një kompani sjellë fara dhe i çon në laboratorin e Entit të Farave, farat certifikohen, bëhet analiza fuqia mbirëse, energjia mbirëse, ngarkesa me parazitë kalon tek instituti. Si veprohet sot?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po në çdo import.

Zoti Panariti tha që futet me çantë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ligjërisht funksionon kështu: unë sjell farën, e kam deklaruar, e kam zhdoganuar, e kam çuar materialin për analizë, bëhet analiza, merr përgjigjen, po ose jo, dhe hidhet në treg. Edhe AKU-ja certifikohet. AKU-ja bën analizën, pra merr kampione për çdo material, për misër dhe për të gjitha gjërat. Pra, ne e kemi në proces në ndjekje dhe të tjerët nuk kanë të drejtë ta mbjellin dhe ta bëjnë këtë veprim. Problemi ku qëndron? Në qoftë se TVSH-në e inputeve bujqësore e bëmë zero, të fidanëve dhe farave, e bëmë për këtë arsye.

Një kosovar sillte fidanë arre dhe lajthie nga Kosova dhe i fuste kontrabandë. Më pyeti mua: “a u hoq TVSH-ja”? Po. Domethënë, TVSH-ja (zoti Panariti e di) ishte një barrierë, që ata i detyronte ta fusnin nga mali, pra i nxiste. Kështu që, kjo gjë bëri që ata të jenë në fushë të hapur,

të konkurrojnë me të tjerët dhe janë të barabartë. Kjo na bën që të ndiehem mirë, nuk do të thotë që këto masa nuk duhen forcuar edhe në doganë.

Sa firma kemi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

72 firma kemi sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka edhe fshatarë, që kanë dështuar vitin e parë për dy arsye: të farës, por edhe të kushteve teknike që kanë kultivuar. Por ka dështuar një herë, më pas ai ka dalë nga tregu si kompani, sepse fjala e keqe hapet si fara e gramit dhe mbaron historia. Kjo tregon kontrollin për ne.

Zoti Baraj bëri një pyetje për Universitetin Bujqësor. Kjo është e vërtetë. Universitetin Bujqësor ka qenë lokomotivë e shkencës, ende edhe sot Universiteti prodhon farë. Përfundimisht Universitetin Bujqësor këtë vit do të mbështetet me rreth 1 milionë euro për të ngritur bazën eksperimentale, didaktike, ku ka një projekt shumë ambicioz. Unë e kam parë atë projekt, kam kontaktuar dhe kjo do të bëjë që t'i japë jetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Baraj, për sa i përket universitetit, universiteti vazhdon të prodhojë farë gruri, por gjendja në universitet me këtë bazë që është, nuk ka lidhje. Kurse atë që ka në projekt universiteti sot, sepse unë e kam parë projektin, dhe me mbështetjen që po jep i qeveria dhe Ministria e Bujqësisë, pra rreth 1 milionë euro, do t'i marrë tani, me këtë 1 milionë euro dhe me projektin që ka, do të marrë autoritetin që i duhet që të përgatisë kontingjente, që t'i hedhim nesër ushtarë për të luftuar dhe për të punuar në terren. Sepse nga do t'i marrim këta? Brezi po ikën. Ndonjëherë është mirë të flasim sinqerisht me njëri-tjetrin, nuk është halli të bëjmë pozitë-opozitë. Bujqësia shqiptare do plane 10-vjeçare dhe 20-vjeçare, nuk do plane 1-vjeçare. E mora unë, e le ti, ti e bërë, unë nuk e bëra. Janë plane në perspektivë, që marrin në qafë një në komb të tërë. Ju ndërrojini karriget sa herë të doni, por bujqësia duhet të ketë shina, që në këto shina të mos dalë njeri më përpara.

Mua më pëlqen oponenca për të thënë: sikur të bëjmë edhe këtë, sikur të bëjmë edhe këtë, këtë e kemi bërë mirë, ta bëjmë keq. Mendoj se te kjo punë nuk ka opozitë, por o burra ta vëmë ndonjë gurë te bujqësia, të majtë, të djathtë, të verdhë dhe të kuq, por realisht fermerët duhen mbështetur për këtë gjë.

Për sa u përket institucioneve shkencore, mendoj se i jemi futur gjësë së duhur dhe pasi të bëhet të shikojmë sa impakt do të ketë, sepse janë bërë shumë gjëra për shou, por mendoj se ata do t'i thërrasin mendjes, sepse studentët e mirë sot i eliminon tregu. Vërtet mund të dalësh i mirë dhe me dhjeta, por kur ndeshesh me realitetin, asnjë kompani private nuk të merr. Kështu që, kjo është historia që universiteti duhet të jetë në konkurrencë me vetveten për të përballuar tregun dhe kërkesat që ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo ka sipërfaqen e saj, ka rreth 125-130 hektarë gjendje. Një pjesë i është zënë, por kjo shpërfaqje besoj se është e bollshme për të realizuar këtë.

Zoti Sinaj bën një ndërhyrje dhe e bën praktike, sepse është më afër me fshatarët dhe kjo është e vërtetë. Kontrolli i farave dhe liberalizimi ka dy të mira, e mira është bashkë me të keqen. Liberalizimi do të thotë: a do të kemi ne kapacitete që ta kontrollojmë, apo jo? Problemi është se ne përpiqemi të kemi kapacitete, për të qenë sinqertë me veten këto kapacitete nuk i kemi të plota. Disa gjëra janë në dorë edhe të rastësisë, por ne përpiqemi të ndërtojmë struktura që t'i vëmë në kontroll gjërat. Ka pasur dështime, por monopoli ka një të keqe, që ju e dini, nuk ka konkurrencë. Kur nuk ka konkurrencë, do të thotë se ai mund të bëjë si të dojë, komandon tregun dhe sjell atë farë misri dhe t'i je i detyruar ta mbjellësh atë farë misri, pra nuk provon një gjë të re, nuk ke një mundësi të dytë, dhe vazhdon monopoli. Kurse për sa i përket problemit, kjo ka një problem me doganën.

(Diskutime pa mikrofon)

Jam dakord, por kjo punë të çon në vitet e mia dhe të zotit Panariti. *(Diskutime pa mikrofon)*

Edmond Panariti – Shanset e ndonjë hileje janë shumë të mëdha.

Dhimitër Kote – Unë e thashë, risk është edhe njëra, edhe tjera, por nuk mund t'ia heqësh të drejtën atij për kushtet që ne do të vendosim, sepse nuk do të heqim kushte, që do të jenë të kontrollueshme nga ne.

Edmond Panariti – Meqenëse bëhet fjalë për siguri kombëtare.

Dhimitër Kote – Ne përpiqemi dhe deri tani, për shkak të vëmendjes por edhe Zoti na ka ruajtur, që nuk jemi bërë epiqendër e viruseve të rrezikshme që kanë qarkulluar në Itali dhe në Greqi. Për shembull, po marr sëmundjen që ka kapur Spanjën për agrumet, është një virus për të cilin janë shkukur me mijëra hektarë.

Edmond Panariti – Si e ka Greqia, e ka të liberalizuar tregun e importeve të farëra dhe fidanëve?

Dhimitër Kote – Çfarë kuptimi ka liberalizimi?

(Diskutime pa mikrofon)

Liberalizimi nuk është liberalizim që çdo njeri do të vijë të marrë dhe të bëjë. Problemi është se nuk do të marrë më autorizimin. Për shembull, unë, Dhimitër Kote e kam marrë licencën, kur ka qenë ministër zoti Panariti, por duhet të vija çdo vit dhe të marrja autorizimin. Ndërsa tani, kur kam marrë patentën, nuk duhet të shkoj çdo vit që të marr autorizimin për t'u likuiduar vitin tjetër. Këtë përfshin kjo, jo liberalizim që mund të hyjë çdo njeri kot. Por me licencën, je i regjistruar dhe aplikon për këtë punë dhe plotëson kushtet tona, pra të kesh agronomin, të kesh ambientin, të kesh këtë dhe pasi verifikohesh nga AKU-ja dhe nga ne, sepse kështu funksionon, atëherë ke të drejtën që të vazhdosh të bësh këtë procedurë. Vetëm kështu funksionon. Liberalizimi nuk është o burra, çdo njeri të marrë të sjellë. Pastaj liberalizimi mund të ketë çdo njeri për një biznes, por kur kanë hapur shumë dyqane dhe lokale më pas kanë dështuar. Këpucari janë 20 rresht, por reziston më i forti dhe të tjerët kanë dështuar. Këtu ka një gjë tjetër, që dëmi që bën është shumë i madh dhe nuk rikuperohet, sepse a ka mbjellë një fidan që do të rrojë 50 vjet, nuk është se ka mbjellë një bimë 1-vjeçare. Kështu që ne nuk e themi fjalën liberalizim, që o burra të hapen dyert dhe portat të futet çdo njeri. Jo, në asnjë mënyrë! Por biznesi nuk do të ketë më sorollatje në kohë dhe në shërbim. Të njëjtët njerëz që e kanë këtë të drejtë, do të vazhdojnë ta kenë. Një njeri që plotëson kushtet, është si një njeri që do të hapë një thetore të re, një magazinë të re e të tjera.

Niko Peleshi – Më fal, zoti Kote, që ta sqarojmë këtë! Në qoftë se unë dua të importoj material mbjellës, çfarë kushtesh duhet të plotësoj? Thjesht të kem në licencë, domethënë te fusha e aktivitetit të kem edhe këtë apo duhet të marr një autorizim të veçantë nga ministri ose një leje nga QKL-ja?

Dhimitër Kote - Duhet të marrësh një leje nga QKL-ja. Problemi qëndron se në momentin që ti kërkon të bësh këtë veprim, duhet të plotësosh disa kushte, duhet të kesh një agronom të licencuar, duhet të kesh informacion për këtë gjë, duhet të kesh kushte ku ta mbash fidanin për të bërë dezinfektimin, për të bërë spërkatjen, për të bërë trajtimin. Domethënë, nuk mund të marrësh në çantë, ashtu siç tha zoti Panariti, një qese me fara dhe ta bësh. Këtë mund ta

bëjnë edhe fshehurazi, sepse mund të fusin edhe lëndë narkotike, por ky është një tjetër proces. Por duhet të plotësosh këto kushte që të kesh të drejtën e kësaj.

Niko Peleshi - Pra, ndryshimi në këtë ligj është se nuk e rifreskon çdo vit autorizimin?

Dhimitër Kote – Po, vetëm kaq.

Niko Peleshi - Po lejen fillestare nga e merr?

Dhimitër Kote – Merret vetëm nga QKL-ja.

Niko Peleshi - Po ndryshimi cili është, që nuk merret autorizim çdo vit?

Dhimitër Kote – Nuk merr autorizimin çdo vit.

Niko Peleshi - Urdhëroni!

Edlira Llango – Sipas ndryshimeve ligjore, praktikisht nga QKL-ja që është bërë tashmë QKB, pra ish-QKR-ja, duhet të ketë të regjistruar në objektin e veprimtarisë prodhimin kategorive ose importimin e kategorive të larta të materialit të mbjellë dhe shumëzuesbimor dhe hiqet licenca nga QKL-ja. Kjo licencë ishte një licencë e kategorisë së dytë, nga ato me vetëdeklarim, ku subjekti shkonte vetëm një herë, në fillim fare të aktivitetit të tij, deklaronte drejtuesin teknik dhe ambientet e përshtatshme, dhe më pas pajisej me licencën e tregtimit apo të importimit të materialit të mbjellë dhe shumëzuesbimor. Megjithatë, me heqjen e kësaj licence, nuk bie në asnjë moment kontrolli, sepse në çdo moment, që në momentin që regjistrohet në QKB, që kanë objekt veprimtarie këtë veprimtari, AKU-ja mund të fillojë të bëjë kontrollin sipas ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm i hiqet biznesit barra që të shkojë në QKL dhe të pajiset me këtë licencë, e cila merrej në bazë të deklarimit të këtyre subjekteve. Kjo ishte vetëm një herë si licencë, pas herës së parë nuk shkon më, sepse duke e deklaruar në QKB, AKU-ja mund të njoftohet menjëherë për këtë veprimtari. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dhimitër Kote – Domethënë, në momentin që unë shkoj, ashtu siç shkoja, sepse edhe unë kam nxjerrë, kam shkruar: “Prodhim, import dhe eksport të fidanëve”, ose në momentin që ti shkon në QKB dhe e deklaron këtë gjë, ka disa pika të tjera, të cilat qëndrojnë që të gjitha po ti nuk shkon më në ministri, të kesh procedurë, të paraqitesh dhe të krijosh histori. Plotëson të gjitha kushtet, AKU-ja merr informacionin që kompania final ka bërë këtë regjistrim, futet dhe të vjen në terren dhe të kërkon dokumentacionin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është bërë me një stacion.

Niko Peleshi – Nuk është se është liberalizuar në kuptimin që të jenë hequr kërkesat. Kërkesat qëndrojnë, por ti e fillon aktivitetin me përgjegjësinë tënde. Domethënë, je subjekt kontrolli i vazhdueshëm, në qoftë se ti këtë hapësirë që të jep ligji, pra nuk ke nevojë të marrësh licencë, e shfrytëzon për keq e merr riskun vetë, sepse mund të vijë AKU-ja të kontrollojë, të gjen që ushtron aktivitet pa plotësuar kriteret dhe dënoshesh, apo jo? Ky është ndryshimi.

Dhimitër Kote – Pyetja tjetër që bëri zoti Sinaj: kush përgjigjet në qoftë se dështon një fermer? Kjo është si thembra e Akilit, është normale, sepse fermerët tanë duhet t'i sqarojmë (më pëlqeu zoti Panariti, e tha drejt atë gjë), sepse edhe nga eksperiencia në këtë sektor është se duhet të kenë informacion fermerët: duhet ta marrin me faturë, me TVSH fidanin. Pastaj të hysh në procedurat e tjera që ne të verifikojmë, nëse është faji i farës apo është faji i shërbimit që ti nuk ke përgatitur kushtet, sepse ti nuk lë gjurmë, në momentin që thua: “Po, kush ta dha?”. “Ma dha ai”. Kështu ka ndodhur te serrat, me kastravecën, ka ndodhur me misrin, me domaten. Kur shikojmë domaten, kur e presim e ka ngjyrën kështu, e ka ashtu, kjo për shkak të degjenerimit të farës. Po jua them sesi ndodh te fara. Merret fara kur bëhet kalibrimi i saj ose triorimi që i thoshim ne atëherë, merret farë e gjeneracioni të parë që ka parametrat dhe madhësinë, e njëjta farë është, por bimët e dëmtuara nuk prodhojnë dot farën e saktë. Ajo farë ndahet në 3 kualitete, ai që e prodhon farën në Francë, merr cilësinë e parë dhe të dytë i shet, të tretën ua jep miqve me çmim të ulët. Ky është degjenerimi i farës dhe kjo ka ndodhur. Duke ditur se nga e merr farën, si e merr, ne e kontrollojmë. Ne e bëjmë këtë, por këtë mundësi duhet të na e japin fermerët dhe ne duhet t'u japim informacion atyre që ata të mos bëjnë gabim.

Për sa i përket jonxhës, problemi që ka jonxha është kuskuta, e cila ngjan shumë me farën e jonxhës. Në momentin që ti mbjell vitin e parë, në vitin e dytë kuskuta e ka pushtuar plotësisht. Kuskuta është një bimë e verdhë, që e pushton. Këto fenomene janë të tilla, ne duam informacion se nga kush e ka marrë farën. Kur është pa adresë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Në vazhdim të asaj që tha zoti Sinaj, të përgjigjes që dhatë ju, ju falënderoj për këtë, unë besoj se ideja është pikërisht për rastet kur ne kemi këtë gjurmueshmëri. Pra, dëmi u bë, e dimë, e bëri x kompani. Si shpërblehet fshatari për këtë dëm që iu bë? A kemi mundësi që në këtë skemë të fusim kompanitë e sigurimeve, që të garantojnë këtë

marrëdhënie midis furnizuesit dhe fermerit? Ai dështoi, e dimë. E ka bërë x-i. Kështu i erdhi fara, laboratorit nuk e kapi, fshatari dështoi, mbeti pa prodhim sivjet.

Dhimitër Kote - Atëherë, po jua them. Po marr një rast. Zoti Panariti e di...

Niko Peleshi - Vazhdojmë pak më shpejt dhe më shkurt.

Dhimitër Kote - A mund t'ju sqaroj diçka të vogël?

Niko Peleshi - Ta dëgjojmë zëvendësministrin.

Dhimitër Kote - Ky fenomen ka ndodhur. Ne kontrollojmë energjinë dhe fuqinë mbirëse dhe jo shterpësinë. Shterpësia është një proces tjetër, është një analizë. Çfarë ka ndodhur me një kompani, të cilës nuk po ia përmend emrin, sepse ndodhi? Ajo kompani mori përsipër të zhdëmtojë. Flasim për sasi të mëdha. Ndërsa nën sqetull, në xhep, merr 100 gram farë, se aq i duhen andej. Sa i duhen për një serrë të vogël? Një dynym farë. Një farë bën rreth 1 mijë, 2 mijë, 3 mijë lekë deri në 10 mijë lekë. I duhen 250 bimë në një dynym, aq farë merr. Kur shkon të marrë farën nuk e kontrollon dot, vetëm ta fusë në skaner, aq e imët është. Kompanitë serioze që janë me emër në Shqipëri nuk e pranojnë, unë nuk dua t'i mbroj, as të bëhem partner me ta, por për të thënë të vërtetën, ata kanë mbajtur kosto dhe përgjegjësi për gjërat që kanë dështuar, për raste të veçanta anonime, këto janë pjesë e lojës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për pyetjet që bëri zoti Panariti, nuk dua të kundërshtoj asnjë gjë nga ato që tha, absolutisht jam shumë dakord, ato kanë qenë dhe janë objekt i programit dhe punës sonë. Unë mendoj se jemi orientuar drejt. Nëse kërkojmë këtë përmirësim të këtij neni, e kërkojmë për të bërë një lehtësi, koha ecën shpejt, ne do të përpiqemi t'i përgjigjemi.

Për sa u përket laboratorëve e thashë problemin e liberalizimit, ku është avantazhi, disavantazhi, dakordësohemi edhe me ju. problemi është se për sa i përket laboratorit të akredituar dhe laboratorit tjetër, ai i akredituar akreditohet nga Drejtoria e Akreditimit që është në Shqipëri. Kur nuk dakordësohemi për një analizë, nëse kapet një kamion yni në doganë, i cili ka mbetje toksike mbi nivelin e lejuar, maqedonasi thotë e kam laboratorin tim të akredituar dhe kundërshton. Ti detyrohesh ta marrësh këtë analizë dhe ta dërgosh në një laborator ndërmjetës, për shembull në Selanik, në Itali, që janë kompetentë. Të kthen përgjigje dhe të thonë: “ Po, analiza që keni bërë ju, nuk është e drejtë”. Ne duhet t'ia hapim derën kësaj gjëje, si ide është sot, si ëndërr, të duket sot. Do Zoti bëhet realitet, nëse një kompani private do të shikojë interesin për t'u marrë me këtë gjë dhe nëse ky sektor do të ketë zhvillim. Ne nuk mund ta

ndalojmë dot atë që ka ai në mendje, ka bërë një studim, ka menduar se: do të duhem në treg sot, koha ka thirrur në skenë cilësinë, si e tillë unë e pranoj këtë risi. Ne do t'i krijojmë mundësinë. Nëse ai ka kapital dhe do ta bëjë, ne nuk mund ta ndalojmë që ta bëjë një gjë të tillë. Kjo nuk do të thotë që ne të mos forcojmë laboratorët tanë të akredituar dhe kontrollin nga ferma në tavolinë. Ky është një proces shumë i gjatë, që po t'i hyjmë ka histori, suksese dhe dështime të plota në shumë drejtime.

Edmond Panariti - Po bëjmë më tepër një diskutim miqësor, këtu bëhet fjalë për importe. Shqipëria ka interes edhe për eksporte, ku vlen logjika e akreditimit kombëtar dhe atij ndërkombëtar. Për shembull, Instituti i Sigurisë Ushqimore të Veterinarisë ka akreditim kombëtar, por edhe ndërkombëtar. Pse e ka ndërkombëtar? Mund të ishim mjaftuar me kombëtarin, por e ka ndërkombëtarin se kur vjen puna për eksporte nuk të njeh akreditimin kombëtar. Them se është mirë që ta marrësh nëse e ke të mundur akreditimin ndërkombëtar, sepse ai të jep dorë në këto përplasjet e mëdha edhe të karakterit gjyqësor. Nuk është nevoja ta dërgosh në Selanik, sepse i thua: “Zotëri, unë kam edhe akreditim ndërkombëtar”.

Dhimitër Kote - Ai yni dhe i Entit të Farërave është ndërkombëtar.

Edmond Panariti – E merr te Qendra Kombëtare e Akreditimit ai, vetëm procedurë kërkon, nuk kërkon vërtetësi analizash, saktësi e të tjera, se nuk ka mundësi të kontrollojë në këtë mes, por një qendër kombëtare kontrollon analizën, saktësinë, ndjeshmërinë, metodën e të tjerë. Këtu është diferenca. Është një hap që duhet bërë. Për mua sa është bërë, është diçka shumë pozitive. Hapëm një diskutim, sepse unë kam qenë ministër, sa herë që shkonim në bazë, na bombardonin me fjalët: fara të skaduara. Pra, ishte një shqetësim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhimitër Kote - Nuk e di nëse kam lënë ndonjë pyetje tjetër?

Niko Peleshi - Shumë faleminderit, për përgjigjet!

Ndoshta do të ketë dhe ndonjë pyetje gjatë komenteve. Ka diskutime? Zoti Beqaj kam përshtypjen se ka disa komente?

Ilir Beqaj - Paraprakisht, Komisioni i Ligjeve është duke diskutuar disa probleme në Kodin Penal, që lidhen me sigurinë ushqimore. Këto shqetësime që dolën sot mund t'i përfshijmë, të vendosim një komunikim me Komisionin e Ligjeve për të parë se çfarë mund të shtohet në Kodin Penal edhe në funksion të këtyre shqetësimeve që u pasqyruan sot.

Niko Peleshi - Kjo qëndron. Unë do ta thosha se kjo iniciativë ka filluar nga AKU-ja, nga Ministria e Bujqësisë për ndryshimet në Kodin Penal që lidhen me sigurinë ushqimore. Ne mund ta marrim si iniciativë, të përfshijmë edhe forcimin e sanksioneve për këtë lloj kontrabande.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Dëgjova pyetjen e zotit Beqaj për Entin Shtetëror të Farërave dhe të Fidanëve, çfarë roli do të luajë në fushën e farave? Unë nuk e kam idenë. Doja të më sqaroni, si është i ndërtuar, si është i organizuar dhe si e ushtron aktivitetin e tij për të ndihmuar fermerin shqiptar? Duhet të jetë krahas AKU-së, për të mos ndodhur këto gjëra, sepse është edhe institucion më vete, apo jo?

Vlash Tirana– Të nderuar deputetë,

Enti Shtetëror i Farërave dhe i Fidanëve është një institucion që varet nga Ministria e Bujqësisë. Para këtij ligji kemi qenë bashkë me Inspektoratin e Farërave, pas këtij ligji ky i fundit kaloi tek AKU-ja. Tani vazhdon vetëm certifikimi dhe testimi i varieteteve të reja. Enti Shtetëror i Farërave është institucion i lidhur me katër organizata ndërkombëtare dhe përfaqësuesit e tij janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e tyre në: UKOV, OECD, ISTA dhe CBBO.

Enti Shtetëror i Farërave përbëhet nga 3 sektorë të rëndësishëm.

I pari është testimi, që përmendi edhe zoti Panariti, i cili bëhet në Entin Shtetëror të Farërave. Në bazë të ligjit testohen në Shqipëri të gjitha farat që vijnë nga jashtë për një vit. Pasi mbledhet komisioni, ai vendos që të regjistrohen dhe të vazhdojë futja e tyre në Shqipëri apo të pezullohen.

I dyti, është i gjithë prodhimi vendas me farërat dhe fidanët që kontrollohet nga sektori i Certifikimit. Në fund fare lëshohet certifikata për shitjen e tyre, ato që janë kontrolluar gjatë gjithë vitit nga fermerët privatë.

Është edhe sektori i Laboratorit, i cili bën analizat për të gjithë sasinë e mallrave, farërave që hyjnë nga importi dhe që prodhohen në Shqipëri. Kemi bashkëpunim me Institutin e Mbrojtjes së Bimëve, që tani është tek universiteti, por që duhet të kalojë te ne, në Ministrinë e Bujqësisë. Kemi bashkëpunim, sepse marrim rezultatet e analizave fitopatologjike të të gjithë këtyre farërave dhe fidanëve. Pastaj lëshohet certifikata për shitje nga Enti.

Robert Bitri – Si është numri i farërave dhe fidanëve me ato që prodhojmë dhe atyre që vijnë nga importi?

Vlash Tirana - Ne prodhojmë farë jonxhe, gruri dhe pak farë misri. Ndërsa të gjitha të tjerat janë të importit, perimet, përveç patates të gjitha janë hibride, nuk prodhohen dot nga ne. Ne nuk kemi prodhuar asnjëherë farë hibride, më përpara ne kemi bërë hibridizim të farërave që vinin nga Holanda.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, hibridi nuk vazhdon asnjëherë. Hibridi vetëm një vit është dhe pastaj nuk punon.

Robert Bitri - Besoj se me këtë liberalizimin juve ju dalim më shumë detyra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi - Mirë, vazhdojmë

Ju lutem se kështu nuk mbarojmë kurrë!

Robert Bitri - Ju thatë se bëni testimin e farërave dhe të fidanëve që vijnë nga jashtë dhe pastaj jepni dakordësinë për t'i futur. Asnjë farë dhe fidan i importuar nuk hyn në prodhim pa u bërë testimi?

Vlash Tirana - Përveç hibrideve të perimeve.

Robert Bitri - Perimet lejohen, ndërsa gruri dhe misri nuk lejohen, as patatja, as jonxha. Shumë mirë atëherë! Nëse ka fara dhe fidanë, të cilët nuk hyjnë në prodhim pa u bërë testimi i tyre, mendojmë se Enti juaj ka shumë përgjegjësi për këta fidanë.

Ju falënderoj, pasi u informova!

Niko Peleshi – Siç e tha edhe zoti Beqaj, i referohem diskutimit të tij, ne këtu jemi për të bërë ligje të mira dhe me këtë ndryshim që vjen sot bëjmë një hap shumë të mirë drejt krijimit të disa shinave edhe për institucionet e testimit, laboratorët për energjizimin e sektorit duke e bërë atë më pak të rregulluar, duke hequr disa licenca, por nga ana tjetër ne nuk mund të garantojmë dot përmes ligjeve zbatueshmërinë e tyre. Zbatueshmëria e tyre kontrollohet nga ne si komision për sa na takon, por varet nga institucione të tjera. Ne ndonjëherë duam që me një goditje të zgjidhim diçka, por nuk mundet. Sot ne bëjmë një hap të rëndësishëm në kuadrin ligjor. Besoj se sot do të mbyllim miratimin në parim, nen për nen dhe në tërësi të këtij projektligji.

Unë do t'i inkurajoja përfaqësuesit e ministrisë që të vazhdojnë të sjellin propozime për të forcuar dhe për t'i ngritur në një nivel më të lartë qendrat tona, qoftë Entin e Farërave,

qoftë laboratorët, duke krijuar kapacitete të kërkim -zhvillimit në vendin tonë, që për fat të keq i kemi pasur në të kaluarën, por dalëngadalë i quajtëm si të pavlera.

Unë nuk jam agronom, punova më shumë se një vit, edhe në mandatin e kaluar kam qenë pranë kësaj ministrie, pranë zotit Panariti, kemi punuar bashkë, një gjë kuptova, mund të ma kundërshtojë zoti Kote: nuk ka bujqësi kombëtare pa kërkim-zhvillim. Nuk mund ta blesh dot kërkim -zhvillimin. Nuk mund t'i marrësh dot të gatshme nga jashtë. Mund t'i marrësh deri në njëfarë shkalle, por më tej askush nuk prodhon për kushtet, për klimën, mikroklimën që kemi, duhen patjetër institucione kërkim- zhvillimi. Ne i kemi disa baza, që duke i bashkuar dhe duke i fuqizuar, kuptohet që duhen ligje më të mira, por duhen edhe para, mund t'i ndërtojmë këto kapacitete. Për shembull, unë jam surprizuar kur vizituam bashkë me zotin Kote një bankë gjenetike. Pakkush mund ta dijë se ekziston një bankë gjenetike në Shqipëri, që ka 3600-4200 fara të ruajtura. Kjo bankë bënte një punë fantastike dhe kishte një staf me 10-12 profesorë, njerëz të shkolluar, me tituj shkencorë. Mirëpo, ne i kemi prishur vetë këto institucione. Për shembull, nuk e di për ç'arsye iu hoq statusi kërkimor-shkencor ISUV-it. Një pjesë e mirë e doktorëve të shkencave dhe profesorëve ikën nga instituti dhe shkuan në universitet.

Besoj se shumë shpejt do ta kalojmë në parlament ndryshimin që t'i rikthejmë statusin e institucionit kërkimor-shkencor ISUV-it. Duhet të ecim shpejt dhe jam i bindur se në këtë komision po edhe në të gjitha radhët e deputetëve nuk mungon vullneti për t'i fuqizuar dhe për t'i ndërtuar atje ku mungojnë qendrat kërkimore-shkencore.

Unë ju ftoj ta vizitojmë të gjithë së bashku si komision Bankën Gjenetike se do të mrekulloheni. Kam qenë edhe në Bankën Gjenetike të Izraelit, bashkë me Dhimon, dhe kam pyetur se ku mund të ndodhen farat tona të vjetra. Më thanë se, padyshim, ndodhen në një institut në Rusi. Pra, shtetet e tjera, sidomos gjatë kohëve të luftërave ose të marrëdhënieve kanë bërë ekspedita, ndonjëherë të fshehta, ndonjëherë jo të fshehta, për të marrë materialin mbjellës apo biologjik, gjenetik të vendeve të tjera dhe i ruajnë në institutet e tyre, ndërsa ne kemi kohë që nuk e kemi këtë vëmendje. Më vjen mirë që ka një lloj sensibiliteti dhe një punë të filluar, ta mbështesim, të ecim përpara dhe ta çojmë më lart.

Heqja e TVSH-së është një stimul i mirë për formalizimin, sepse është e vërtetë ajo që tha Dhimoja, liberalizimi ka avantazhe dhe disavantazhe. Disavantazhi është që kërkon më shumë kontroll, por kjo s'do të thotë se do të sillemi si doktori Adhamudhi, pra meqenëse shtohet rreziku dhe nevoja për kontroll, atëherë më mirë të qëndrojmë kështu siç jemi. Jo, duhet të

hapemi, të mos e lemë monopol, të shtojmë sa më shumë aktorë në fushë dhe nga ana tjetër të fuqizojmë edhe kontrollin. Tani nuk ka shumë arsye për kontrabandë, sepse nuk paguan asgjë, TVSH-ja është zero për inputet bujqësore, kështu që besoj se terreni është i favorshëm.

(Diskutime pa mikrofon)

Burrë – Ka edhe në Lushnjë bankë gjenetike të grurit dhe të disa perimeve, zoti kryetar.

Niko Peleshi – Po, ka ca fakte që duhet të na bëjnë të skuqemi. Për shembull, te gruri akoma prodhojmë farën “Dajti” që, për hir të së vërtetës, konkurren me farat më të mira edhe të Europës sot. Domethënë, në atë kohë është bërë një punë kërkimore-shkencore për të prodhuar një farë që, ndonëse nuk është përmirësuar për 30 vjet, përsëri është konkurren në treg.

Në qoftë se nuk ka diskutime të tjera e votojmë në parim.

Kush është dakord për miratimin në parim të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” të ndryshuar”.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Kalojmë në diskutimin nen për nen.

Neni 1.

Urdhëroni, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj – Më ndiqni pak, se këtu është më shumë çështje gjuhësore! Them “laborator reference”. A ka një apo disa të tillë?

(Diskutime pa mikrofon)

Po të shkojmë te neni 8, pika 3, themi “kriteret që duhet të plotësojmë laboratorët testues dhe laboratorët e referencës”. Diku shumës e diku njëjës, unë ngatërrohem.

Burrë – Problemi është se ne nuk mund të themi “një”. Mund të çmendet një njeri e të bëjë 3, nuk e ndalon dot.

Ilir Beqaj – Dakord. Pra, lejohet më shumë se një. E kuptova.

Te neni 1, pika 11/2 unë kam propozim të bëjmë një shtesë: “i miratuar nga ministri përgjegjës për bujqësisë”

Meqenëse e themi edhe diku tjetër, ta themi edhe këtu. Siç është thënë tek të tjerat, ta themi edhe këtu, propozoj unë.

Burrë – Propozim i drejtë. E miratojmë.

Niko Peleshi – Dakord.

A ka propozim tjetër? Nuk ka.

Grua – Te neni 1 janë përkufizimet, se cili quhet laborator i referencës...

(Diskutime pa mikrofon)

Te përkufizimet, pika 14 e ligjit ekzistues sqarohet se ministër është ministri përgjegjës për bujqësinë.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Atëherë ta hedhim në votim nenin 1 me vërejtjen që duhet të unifikohet nga shërbimi i komisioni përcaktimi, pra ose këtu të shtohet “ministri përgjegjës për bujqësinë”, ose te ligji bazë të hiqet atje ku përmendet dhe të mjaftohemi me përkufizimin e ministrit.

Grua – Jemi më shumë që të hiqet këtu, sespe ligji përmend gjithmonë ministrin...

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Të zgjidhet teknikisht! Ne kërkojmë unifikim. Pra, vërejtja është të ketë unifikim të nenit 1.

Me vërejtjen për të unifikuar nenin 1, me të gjitha nenet e tjera të ligjit, kush është dakord me nenin 1?

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5.

Urdhëroni!

Ilir Beqaj – Te “përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, inspektori verifikon nëse furnizuesi...”, çfarë verifikimi bën inspektori? Po shtojmë një hallkë të panevojshme.

(Diskutime pa mikrofon)

Grua – Në ekstraktin tregtar të regjistrimit të biznesit është një fushë e cila tregon objektin e veprimtarisë dhe në atë fushë duhet të jetë, që të ketë bërë regjistrimin për këtë veprimtari.

Ilir Beqaj – Si e verifikon?

Grua – Duhet të jetë e shkruar tek ekstrakti. Mund ta verifikojnë online letrën që i paraqet subjekti në momentin e inspektimit...

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Mund ta kem gabim edhe unë, edhe zoti Beqaj, por nuk ka kuptim që ne në këtë ligj të marrim përsipër të përshkruajmë detyrat e inspektorit, sepse mund të bëhet shkak për spekulim.

(Diskutime pa mikrofon)

Verifikimi gjithsesi është detyrë e inspektorit.

Burrë – I gjithë procesi i derregulimit ka për qëllim të lehtësojë procedurat për biznesin dhe të shmangë kontaktet sa më shumë të jetë e mundur, të biznesit me administratën. Nëse i hoqëm një hallkë atij dhe pastaj ia shtojmë inspektorit këtë detyrë, që të vejë dhe të kontrollojë, s’kemi bërë gjë. Inspektori le ta kontrollojë online. Në rast se i lindë ndonjë dyshim, është puna e tij të shkojë e të kontrollojë në vend. S’mundet t’ia shkruajmë në ligj këtë.

(Diskutime pa mikrofon)

Grua – Me këtë derregulim që bëhet, synimi është të hiqet licenca dhe të zëvendësohet, vihet të paktën si detyrim që në objektin e veprimtarisë në QKB të ketë të regjistruar importin e veprimtarive ose tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

Neni 24, i cili ndryshon me pikën 3, që ju cituat, flet për procedurën e importit dhe ka pikën 1 dhe 2, se çfarë bën furnizuesi. Pika 3, siç ka qenë më parë, thotë: “verifikon nëse furnizuesi është i licencuar për importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të specieve që ai importon”. Tani, nuk është më i licencuar, se licencën ia kemi hequr, por ama në objektin e veprimtarisë së tij ta ketë të deklaruar në QKB kryerjen e kësaj veprimtarie.

(Diskutime pa mikrofon)

Burrë – Regjistrohesh që do të sjellësh, kurse për speciet, speciet duhet të jenë të regjistruara, se, nëse specia ose kultivari nuk është i regjistruar në katalogun që kemi ne (kemi një regjistër kur regjistrohen të gjitha).

AKU-ja këtu nuk ka dashur t'i lëkunden pozitativ. Unë jam dakord që të mos jetë. Jam në opozitë me veten këtu.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Me sa kuptoj, propozimi është që te pika 3 e ligjit bazë, që i referohet neni 5, në vend të themi “pika 3 e nenit 24 ndryshon si më poshtë”, të themi: “pika 3 e nenit 24 shfuqizohet”, sepse nuk qëndron as siç ishte në ligjin bazë. Pra, edhe kur thuhej “përveçse sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, inspektori verifikon nëse furnizuesi është i licencuar për importin”, ka pasur kuptim, sepse inspektori qoftë kur kishte licencë, qoftë kur nuk kishte licencë, është regjistrim, inspektori e ka të drejtë verifikimin, nuk ke pse ia rithua edhe një herë këtu. Po morëm përsipër të themi se çfarë bën inspektori duhet të shkruajmë gjithë përshkrimin e punës të inspektorit. Nuk ka kuptim.

Pra, neni 5, propozojmë të jetë pika 3 e nenit 24, shfuqizohet, të paktën me propozimet e deritanishme.

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – A ka të regjistruar mango sot në Shqipëri? Jo. Dakord. Unë dua të sjell mango. Fillimisht do të vij të regjistroj fidanin tek ti, pa bërë akoma importin. Vij me dosje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Dakord pra! Vi një herë dhe e shtoj në regjistrin e fidanëve në Shqipëri, një fidan të ri, të caktuar. Pas këtij momenti vi dhe them. Atëherë, kjo fjali duhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, por ama, unë nuk duhet të kem te leja ime çdo fidan. Unë di që, në sa fidanësh ka në Shqipëri, jam i lirë t'i zgjedh. S'kam pse marr leje paraprake.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, varieteti regjistrohet. Patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I vonë, i hershëm, portokall me shegë, portokall me... S'diskutohet! Patjetër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë jam i mendimit që kjo pikë të bjerë fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po nuk qe në regjistër, nuk e importoj. Unë jam marrë me barnat. Po s'qe i regjistruar bari në Shqipëri, ose po mori një letër të veçantë, nuk futet. Nuk ka pse të jetë kjo fjalë, sepse është detyrë native e zbatimit të ligjit. Nuk e di si mendon ti Niko.

Burrë – S'ka rëndësi që kam ardhur ta mbroj, sepse nuk mund të mbroj një gjë që s' më shkon edhe mua. Kjo është e AKU-së, kuptohet, kompetencat janë në rregullore, inspektori i AKU-së e di se nuk e ndalon njeri që të vejë, që një njeri me uniformë polici të mos ia bëjë me dorë të hapë krahun dhe t'i kërkojë patentën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Dakord, por po shikoj se i gjithë neni 24 ka procedurën e importit, dhe nuk është vetëm pika 3, ku flitet se çfarë bën inspektori. Edhe pika 4, për shembull, thotë: “Inspektimi i materialit mbjellës, lidhur me plotësimin e kërkesave, kryhet në magazinat e furnizuesit ose në treg”. Pika 5 thotë: “Tarifa e marrjes së mostrave”.

Pra, është e gjitha për inspektim.

Pika 2: “Inspektimi i ngarkesës së materialit mbjellës dhe shumëzues kryhet pranë pikës hyrëse të kalimit kufitar, sipas kërkesave të përcaktuara në legjislacion”.

Pra, janë të gjitha pikat për inspektimin.

Ilir Beqaj – Jo, jo, unë s'po them të bjerë neni, por kjo pika këtu, pika 3, kështu siç është, është e tepruar.

Niko Peleshi – Dakord!

Ilir Beqaj – Është fjala për mënyrën se si është shkruar. Thotë: “Është regjistruar në regjistrin tregtar me objekt veprimtarie të species që importon”.

Specie të paregjistruara nuk lejohen dhe pikë. Pse duhet të thuhet këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, materiali mbjellë si specie, pra. Këtë po thotë. Unë kam regjistruar fidanë mangoje. Është i regjistruar fidani i mangos në Shqipëri. Kështu si është thënë, duhet ta kem unë te licenca të regjistruar, të importojë mango. Se kështu është shkruar.

Niko Peleshi – Atëherë ta lëmë siç është, dhe të heqim frazën: “të specieve që importohen”.

Ilir Beqaj – “të specieve që importohen”. Pikë. Te specia e kam unë, se bëhet një për një pastaj.

Niko Peleshi – Të lutem! Pra, të ngelet pika 3 e nenit 24 ndryshon si më poshtë vijon: “3- Përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, inspektori verifikon nëse furnizuesi është regjistruar në regjistrin tregtar, me objekt veprimtarie importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhimo, ta lëmë kështu? Si mendon?

Në rregull! Atëherë kush është dakord?

Ilir Beqaj – Kështu siç e ka bërë ai, e ka bërë që unë duhet të jem i regjistruar paraprakisht për atë specie.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Kush është dakord me këtë propozim? Pra, që të hiqet togfjalëshi: “të specieve që ai importon” në fund të fjalisë, neni 5.

Kush është dakord me këtë propozim? Kundër? S’ka kundër.

Miratohet neni 5, me këtë ndryshim!

Kalojmë te neni 6.

Kush është dakord? Kundër? S’ka kundër.

Miratohet dhe neni 6!

Neni 7.

Ilir Beqaj – Mundem?

Niko Peleshi – Ka një diskutim për nenin 7.

Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Kur vijmë te pika 2, shohim: “Propozon për ndalimin përkohësisht...”.

Tashti, ka rregulla se sa është kjo përkohshmëria, si anulohet përkohshmëria? Se këtu fillojnë ato cicmicet në zbatim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu fillojnë. Çfarë do të thotë: përkohësisht? Ka një rregull, X ditë. Kush e rregullon këtë gjë? Kush e normon këtë përkohshmëri, e pastaj edhe anulimin e përkohshmërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk po shkojmë te pjesa e dytë. Jemi te pjesa e parë. Propozon për ndalimin e përkohshëm. Dakord! Sa është përkohshmëria? Kur shkrihet përkohshmëria?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Si propozoni të formulohet atëherë?

Ilir Beqaj – Le të kuptojmë se çfarë ka parasysh me këtë gjë njëherë. Ta kuptojmë njëherë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Mikrofonin, Dhimo!

Dhimiter Kote – Në qoftë se ai është kapur njëherë me shkelje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Propozon për ndalimin përkohësisht të zbatimit të veprimtarive të furnizuesit, nëse furnizuesi ka shkelur kushtet për licencimin, ose propozon heqjen e licencës për rastet kur detyrat e lëna nga ai...”

Ilir Beqaj – Sa është përkohshmëria?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhimiter Kote – Nuk është me orë. Kjo është: sa kohë, sa ditë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ose deri në plotësimin e kushteve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ka ndonjë sqarim nga ministria?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhimiter Kote – Ne nuk ofendohemi. Kjo që keni ju është eksperiencë, dhe ne e mirëpresim. Prandaj vijmë e kalojmë këtu në sitë ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Besnik, më fal, si propozoni ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik, të lutem, a ke ndonjë propozim, që të dalim nga ky ngërç?

Besnik Baraj – Ka një arsye pse i është ndaluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Atëherë çfarë propozon, të lutem?

Besnik Baraj – “Propozon për ndalimin e përkohshëm të zbatimit të veprimtarive të furnizuesit, deri në plotësimin e kushteve”.

Niko Peleshi – Jeni dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Plotësimin e kushteve, të cilat janë të përcaktuara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grua – Ta citojmë: “Për regjistrimin e objektit të veprimtarisë në regjistrin tregtar”, që të jemi të qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për regjistrimin e veprimtarisë në regjistrin tregtar, pra të veprimtarisë së importit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Në rregull!

Kush është dakord me nenin 7, të ndryshuar pak a shumë? Pastaj rregullimi teknik do të bëhet nga shërbimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, të lutem, ta mbaroj fjalinë!

“Propozon për ndalimin përkohësisht të zbatimit të veprimtarive të furnizuesit, nëse furnizuesi ka shkelur kushtet e përcaktuara, apo deri në plotësimin e kushteve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, për regjistrimin në regjistrin tregtar të veprimtarisë të importit të materialit mbjellës”, ose “Propozon ndalimin e zbatimit të veprimtarisë së furnizuesit për rastet kur detyrat e lëna nga ai nuk janë zbatuar për më shumë se dy herë”.

Kush është dakord me këtë formulim të neni 7?

Miratohet me këtë ndryshim.

Neni 8.

Ilir Beqaj – Mundem?

Niko Peleshi – Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Kam një pyetje. Kur themi “analiza laboratorike zyrtare”, çfarë kemi parasysh?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptova. Vetëm ato? Në rregull! Dakord!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, të akredituar do të ketë edhe të tjerë. Përveçse është i akredituar, ai ka një rol më shumë në ligj apo jo? Mos është më mirë ta citojmë si ent.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj – Përndryshe duhet futur te përkufizimet kjo...

Ilir Beqaj – Një sekondë, një sekondë! Shikoni si është fjalia:

Niko Peleshi – Ke të drejtë.

Ilir Beqaj – “Analiza laboratorike zyrtare kryhet në laboratorë testues”. Këtu e ke hapur lojën vetë. Edhe zyrtare, edhe ke hapur lojën. Domethënë, edhe do ta mbash vetë, por pastaj hap lojën.

Niko Peleshi – Më fal! Si e keni idenë? E keni fjalën për analizat që kryhen nga enti i farërave, apo edhe për analizat që kryhen nga laboratorë. Si e keni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po prit pak, se ka dy kuptime. Në qoftë se qëndron kështu siç është, Beqaj ka të drejtë. Edhe analiza laboratorike nga një laborator testues, privat, jo zyrtar, quhet zyrtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, a ka mundësi të bëj edhe unë një pyetje?

Zoti drejtor, edhe ti, Dhimo: çfarë keni dashur të thoni me këtë fjalën “zyrtare”. Doni të thoni: Enti Kombëtar i Farërave? Në qoftë se keni dashur të thoni këtë, atëherë ta riformulojmë: “Analizat laboratorike të kryera nga Enti Kombëtar i Farërave, i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor...

Ilir Beqaj – Bie fare fjalia.

Niko Peleshi – Bie fjalia.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka kuptim. Keni dashur të thoni se mund të bëhet në çdo laborator, mjafton të jetë i licencuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet të kuptojmë se ç’ka dashur të thotë autori.

Ilir Beqaj – Po pra!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grua – Se mund të ketë edhe privatë që nuk i miraton ministri. Mund të ketë edhe privatë të tjerë, të cilët nuk i miraton ministri. Ministri miraton ata, në të cilët kryhen analizat laboratorike zyrtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse përveç entit, mund të bëjnë edhe privatët për interesat e tyre. Prandaj ka qenë fjala “zyrtare”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ministri miraton vetëm ata laboratorë, në të cilët kryhen analiza zyrtare. Sa për pjesën tjetër, mund të ketë edhe ndonjë laborator privat, i cili është i akredituar në treg, që punon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Po analizat njësoj duhet të quhen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grua – Po, por ky nen flet vetëm për analizat zyrtare.

Niko Peleshi – Ju lutem, flisni me radhë dhe kërkojeni fjalën!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

O zoti Bici, të lutem! Në qoftë se do të flasësh, kërkoje fjalën dhe merre kur të duash.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thjesht që të kuptojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thjesht me qëllim që, nëse ka ndonjë propozim, të regjistrohet dhe ta kuptojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të bëj një propozim

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi - ... çfarë nënkupton me “zyrtare”, pastaj ta pranojmë apo ta ndryshojmë, se nuk mund të kalojmë diçka që nuk e di askush se çfarë do të thotë.

Burrë – Ky është një propozim që ka bërë AKU-ja, në fakt.

(Diskutime pa mikrofon)

Besnik Baraj – Për mendimin tim këtu mund të ketë vend për klientelizëm dhe për abuzim. Në këto rrethana unë do të propozoja “analizat laboratorike të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, kryejnë laboratorët testuese të certifikuara (të shtohet) akredituar dhe/ose në laboratorë referuese, miratuar nga ministri përgjegjës për bujqësinë”.

Pra, “zyrtare” duhet hequr, sepse “zyrtare” është një appendiks që ka ngelur nga koha kur kishte vetëm laboratorë shtetërorë, ose ne duket të themi “analiza zyrtare quhen të gjitha ato analiza që merren nga laboratorët e akredituar ose nga laboratorë referente”...

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Një sqarim, Edlira.

Edlira ... – Edhe në pjesë të tjera të ligjit flitet për certifikim zyrtar, domethënë analiza që kryhet nga klienti, kështu që ne do të ishim të mendimin që fjala “zyrtar” të mbetej, pastaj, nëse duhet specifikuar a është nga enti apo jo, kjo është gjë tjetër.

(Diskutime pa mikrofon)

... ose t’i japim një përkufizim se cila është analiza zyrtare.

Niko Peleshi – Edlira, pyetja është kjo: Një analizë e një laborator testues privat të akredituar dhe të miratuar nga ministri, a quhet analizë laboratorikë zyrtare?

Edlira Llango – Zyrtare quhet nëse e kërkon një institucion shtetëror që të kryhet ajo analizë, ndaj është zyrtare. Domethënë, nëse është një analizë që i shërben entit për të bërë regjistrimin.

Niko Peleshi – A jeni të sigurt për këtë? Nëse jeni të sigurt duhet ta shtojmë te përkufizimi.

(Diskutime pa mikrofon)

Robert Bitri – Zyrtare është çdo gjë që është zyrtare, e akredituar. Po që laborator i akredituar nga ministri, është zyrtar. Pra, nëse ka akreditimin e ministrit, çdo laborator quhet laborator zyrtar.

Besnik Baraj – A të bëj një propozim?

Ta lëmë edhe fjalën “zyrtare” dhe në përkufizim të shtojmë: “analiza laboratorike zyrtare konsiderohen”, shtojmë një fjali këtu dhe kaq.

Niko Peleshi – Pra, në qoftë se ju jeni të qartë dhe të bindur se këtu bëhet fjalë për analiza laboratorike, të cilat i kërkon institucioni, pra vetëm ato quhen “zyrtare” dhe nëse e kërkon institucioni, ajo mund të kryhet edhe në një laborator privat, të akredituar nga ministri, quhet “zyrtare” (përdoret edhe në anglisht “oficial”) kur e kërkon një institucion shtetëror. Në qoftë se është kjo, atëherë ta shtojmë te përkufizimi dhe e mbylлим.

(Diskutime pa mikrofon)

Për ku duhen këto analiza zyrtare, Edlira?

Edlira Llango – Po ta lëmë kështu, i bie që çdo laborator i akredituar, edhe privat, që vepron në Republikën e Shqipërisë të miratohet nga ministri, ndërkohë që mbase nuk është e drejtë që çdo laborator privat, që nuk ka lidhje me analizat, të miratohet nga ministri. Sipas legjislacionit në fuqi, ai akreditohet dhe vazhdon punën, që do të thotë se edhe një fermer për nevojat e tij shkon në një laborator privat dhe nuk pa pse ky të jetë i miratuar nga ministri, në

momentin që është i akredituar. Ministri miraton ato laboratorë, që për nevoja të kontrollit duhet të marrin një rezultat dhe mund të ishte fare mirë edhe FSHF-ja, por unë nuk jam e sigurt nëse mund të jetë, për shembull, edhe AKU-ja që të kërkojë një kontroll mbi këtë material ...

(Diskutime pa mikrofon)

... të bëjmë një përkufizim të mirë se cilat konsiderohen analiza zyrtare.

Niko Peleshi – Atëherë, propozimi është ta lemë kështu siç është dhe të shtojmë një përkufizim se cilat janë analizat laboratorike zyrtare. Analiza laboratorike zyrtare quhen analizat e kërkuara nga institucionet shtetërore në përmbushje të misionit të tyre.

Ju lutem, mbajeni shënim!

(Diskutime pa mikrofon)

Mbi ç’bazë i ndan laboratorët që janë të akredituara ministri? Ku mund të bëhen analizat zyrtare dhe kur nuk bëhen?

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Nuk po kuptohemi. Për mendimin tim, ka ca analiza që u duhen institucioneve shtetërore. Institucionet shtetërore në stadin e sotëm të besimit do të thonë se për nevojat e institucionit tim unë dua ta kem rrethin...

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Më falni, po ta lexojmë në mënyrë integrale, kjo gjë është e sqaruar. Te përkufizimet kemi laborator referencë, kemi laborator të akredituar, kemi dhe laboratorë të miratuar.

Laboratori i miratuar është laborator testues, i miratuar nga ministri për kryerjen e analizave të materialit mbjellës dhe shumues bimor, sipas përcaktimeve të nenit 44 të këtij ligji. Neni 44 flet për analizat laboratorike zyrtare. Pra, ato laboratorë që janë laboratorë testues të akredituar dhe që kanë edhe miratimin e ministrit, pra kanë marrë statusin “Laborator i miratuar”, qoftë ky shtetëror apo privat, te këto lloj laboratorësh mund të kryhen analiza laboratorike zyrtare, do të thotë që janë të kërkuara nga institucionet zyrtare në përmbushje të misionit të tyre. E vetmja gjë që këtu mungon është përkufizimi se çfarë quhet analizë laboratorike zyrtare.

Propozimi është ta hedhim në votë nenin 8, siç është formuluar këtu.

Neni 8, pika 1.

E votojmë siç është me vërejtjen që të shtohet përkufizimi se çfarë quhet analizë laboratorike zyrtare.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet pika 1 e nenit 8.

Pika 2 e nenit 8.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet pika 2 e nenit 8.

Pika 3.

Urdhëroni, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj – Unë kam sugjerimin që këtu do të ishte mirë që, jo vetëm kriteret të përcaktohen me udhëzim të ministrit, por edhe procedura.

Te pika 3 themi: “Kriteret që duhet të plotësojnë laboratorët, përcaktohen me udhëzim të ministrit”. Po procedura?

(Diskutime pa mikrofon)

Procedura e miratimit, procedurën administrative, jo si bëhet analiza.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë them: “Procedura dhe kriteret”.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë jam laborator testues dhe vij të aplikoj. Kriteret i përcakton ministri. Po që unë u bëra laborator testues, a ka një procedurë, (aplikoj diku, a ka një afat, marr një përgjigje, kam një korrespondencë)?

(Diskutime pa mikrofon)

Pikërisht, që të jetë derregulim, se po nuk që këtu, i përgjigjet ministria me Kod të Procedurave Administrative.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Edhe shërbimi mendon se mund të shtohet. Kush është dakord që të shtohet dhe të bëhet: “Kriteret dhe procedurat që duhet të plotësojnë laboratorët testues dhe laboratorët e referencës për t’u miratuar përcaktohen me udhëzim të ministrit, që mbulon fushën e bujqësisë”?

Robert Bitri – Më falni! “Kriteret që duhet të plotësojnë laboratorët testues dhe laboratorët e referencës, si dhe procedurat e miratimit të tyre” dhe vazhdon.

Niko Peleshi – Dakord me këtë formulim të zotit Bitri? Kush është dakord?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet pika 3 e nenit 8.

Pika 4.

Udhëroni, Besnik!

Besnik Baraj – Të merret me mostrat dhe të firmosë ministri, kur këto janë standarde.

Procedura që ndiqet për marrjen e mostrave...

(Diskutime pa mikrofon)

Këto janë të përcaktuara, janë në standardet e BE-së...

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ministri themelon standardin me një udhëzim dhe pastaj puna vazhdon.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet pika 4 e nenit 8.

Pika 5.

Urdhëroni!

Ilir Beqaj – Në bazë të diskutimit që u bë në fillim, unë do të thosha “lista e analizave që kryhen nga laboratorët e referencës të botohet në FZ”, se derisa ata mund të jenë më shumë se një, ia boton i pari, por i dyti nuk ia boton më. Prandaj unë pyeta fillimisht, një apo shumë.

Niko Peleshi – Kush është dakord me propozimin që lista e analizave që kryhen nga laboratorët e referencës të botohen në Fletore Zyrtare”.

(Diskutime pa mikrofon)

Më falni, testet apo analizat akreditohen rast pas rasti, pra nëse ai akrediton një test të caktuar, e shton në listën e vet.

Ilir Beqaj – Atëherë, s'ka kuptim fare pika 5.

Niko Peleshi – Më falni, botohet në Fletore Zyrtare.

Kush e përcakton, cili akt? Edlira, si është në ligjin bazë?

Edlira Llango – Nuk është në ligjin bazë. Kjo është një shtesë që është bërë edhe për këtë arsye që tha zoti deputet, që është e mira të jenë të publikuara në FZ. Në momentin që ministri do të miratojë laboratorin e referencës, në të duhet të jetë edhe lista e analizave.

Do të bëhet një miratim shtesë, sepse nuk mund të jetë një laborator i akredituar për të gjitha.

Niko Peleshi – Pra, me urdhër ministri.

Kush është dakord që pika 5 e nenit 8 të riformulohet: “Lista e analizave që kryhen nga laboratorët e referencës miratohet me urdhër ministri dhe botohen në Fletore Zyrtare”.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet pika 5 e nenit 8.

Kush është dakord për miratimin në tërësi të nenit 8?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet neni 8 me ndryshimet e bëra.

Neni 9.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet neni 9.

Neni 10.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet neni 10.

Neni 11.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet neni 11.

Kush është dakord për miratimin në tërësi të ligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” të ndryshuar””?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet edhe në tërësi.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA